



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 62 prot.

Kamëz, më 19.05.2021

V E N D I M:

Nr. 54 .Datë 19/05 2021

PËR

MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN NR. 168 DATË 23.12.2020 TË LISTËS SË SUBJEKTEVE, TË CILËT PËRFITOJNË NGA GRANTET PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMRTIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, VLERËSUAR SIPAS NIVELIT TË DËMTIMEVE NGA DS1-DS3

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **19.05.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt – Vendim Nr.46 Datë 11.05.2021** në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, aktin nr. 09 datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe aktet nënligjore për zbatim të tij, Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendim Nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendim Nr.8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, Vendim Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Vendim Nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit”, Urdhërit nr. 617 datë 11.12.2020 “për ngritjen e komisionit të posaçëm të rindërtimit për aplikuesit në Njësinë Administrative Paskuqan, sipas listës bashkangjitur”,
Këshilli Bashkiak Kamëz:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

V E N D O S I :

1. Miratimin e një ndryshimi në Vendimin nr.168 Datë 23.12.2020 të subjekteve përfitues, të cilët në këtë fazë konstatohet mosplotësimin e kriterëve ligjore për të përfitua nga grantet e rindërtimit për masën e dëmtimeve sipas DS-ve:

1. DS1 - Nivel dëmtimi lehtë;
2. DS2 - Nivel dëmtimi mesatar;
3. DS3 - Nivel dëmtimi serioze;

2.Miratimin për vlerën në lekë hartuar nga Komisioni Teknik sipas urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr. 155 datë 24.02.2020 për përcaktimin e vlerës të masës së grantit të rindërtimit sipas nivelit të dëmtimeve nga tërmeti.

Relacioni u dorëzua pranë Komisionit të Posaçëm me Nr.3784 prot datë 26.05.2020 dhe si më poshtë vijon:

DS-1 përfiton grantin me vlerë 90,154 (nëntëdhjetëmijë e njeqin e pesëdhjete e kater lekë)
DS-2 përfiton grantin me vlerë 230,060 (dyqind e tridhjetëmijë e gjashtedhjetekë)
DS-3 përfiton grantin me vlerë 450,062 (katërqind e pesëdhjetëmijë e gjashtedhjete e dylekë)

3. Lista e subjekteve që shfuqizohen në pikën 1 të këtij vendimi, paraqitet në aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Nën/Kryetar Këshilli
Ali Dauti

